

Proftrans Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Proftrans Sh.p.k ("Shoqëria") është një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar në Shqipëri. Adresa e Shoqërisë është Rr. Llazi Miho, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria është regjistruar me NUIS I.81325027S dhe aktualisht raporton pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Shoqëria ka si objekt veprimtarie transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave për vete dhe për të tretë. Drejtuesi i Shoqërisë është Z. Ergys Halili.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK).

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është njëkohësisht dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

2.5 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të jetë në gjëndje të realizojë aktivet dhe të shlyejë detyrimet gjatë rrjedhës normale të aktivitetit për periudhën pasardhëse 12 mujore.

Gjatë vitit 2021 shoqëria vazhdoi përballjen me pandeminë Covid-19 e shpallur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në 11 Mars 2020. Shoqëria vlerëson se gjatë vitit 2021 përballoi me sukses efektet negative të saj. Manaxhimi do të vazhdojë të monitorojë situatën për çdo ndikim të mundshëm duke ndërmarrë gjithashtu të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar çdo efekt, dhe gjithashtu vlerëson se këto efekte nuk do të kenë ndikim negativ në vijimësinë e Shoqërisë për 12 muajt e ardhshëm.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit njihen përgjithësisht në fitime ose humbje.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Monedha	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
1 EUR	120.76	123.70

Proftrans Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

1 USD

106.54

100.84

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiarë jo-derivative përbëhen nga të drejta të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, llogari të financimeve të brendshme, llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiarë njohen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative njihen siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët t tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e të drejtave të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që të drejtat e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjoni llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e vlerësuar për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të drejtat e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme i përafrohen vlerës së tyre kontabël.

3.3 Aktivet afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar. Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me përgatitjen e aktiveve në gjendje pune për qëllimin e përdorimit të tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementëve dhe rikthimin e tokës në gjendjen origjinale. Programet (softëare) e blerë të cilët janë pjesë tërësore në funksionalitetin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohen si pjesë e kësaj pajisjeje. Kur pjesë të një aktiviteti material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si të ndara (pjesë të rëndësishme). Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë aktiviteti përcaktohen duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të aktivitetit dhe pasqyrohen neto në zërin të ardhura të tjera të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata të trupëzuara i shtohet vlerës së mberur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që lidhen me këtë element do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me saktësi. Kostot e mirëmbajtjeve ditore të aktiveve afatgjata të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Proftrans Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Amortizimi

Amortizimi llogaritet për të shpërndarë koston e aktiveve minus vlerën e tyre të mbetur gjatë jetës së dobishme dhe përgjithësisht njihet në të ardhura dhe shpenzime. Përmirësimet e ambienteve me qira amortizohen përgjatë afatit të qirasë. Aktivet në proçes nuk amortizohen.

Jeta e dobishme e vlerësuar, normat e amortizimit të vitit dhe metodat e paraqitura më poshtë, janë zbatuar për periudhën aktuale dhe atë krahasuese.

• Ndërtesa	vlera e mbetur me 5%
• Automjete	vlera e mbetur me 20%
• Pajisje Zyre & Informatike	vlera e mbetur me 20 - 25%
• Aktivet jomateriale	vlera e mbetur me 15%

3.4 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të vlerësohet me besueshmëri dhe do të kërkojë flukse dalëse monetare të ardhshme për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset monetare të ardhshme të pritshme me një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.5 Njohja e të ardhurave

Shoqëria është e përfshirë në tregëtimin e energjisë elektrike. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet nga pronësia i janë transferuar klientit, rimarrja e shumës është e mundëshme, kostot e lidhura dhe krhimet e mundshme mund të vlerësohen me besueshmëri dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për tu arkëtuar, neto nga krhimet. Për shitjen e energjisë, transferimi i rreziqeve dhe përfitimeve ndodh kur sasia aktuale e energjisë hidhet në rrjet dhe matet në pikën e shpërndarjes.

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në fitime ose humbje. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesat nga huatë dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.7 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në fitim ose humbje, përveçse kur lidhet me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar nga të ardhurat e tatueshme, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose thelbësisht në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimi.

Proftrans Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

4. MJETE MONETARE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Para në arkë	750,665	3,660,937
Para në bankë në LEK	5,647,562	1,181,406
Para në bankë në Monedhë të huaj	107,828,278	29,211,185
Totali i mjeteve monetare	<u>114,226,505</u>	<u>34,053,528</u>

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Të arkëtueshme nga klientët	18,973,131	47,824,050
Totali	<u>18,973,131</u>	<u>47,824,050</u>

6. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Parapagime në doganë	23,648	12,835
Paradhenie punonjese	-	22,388
Totali	<u>23,648</u>	<u>35,223</u>

7. INVENTARËT

Inventarët dhe lëvizjet e tyre më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Inventarët	8,667,599	-
Totali	<u>8,667,599</u>	<u>-</u>

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Gjëndje në fillim të vitit	-	-
Blerje gjatë vitit	9,221,390	12,734,432
Pakësime gjatë vitit	(553,792)	(12,734,432)
Gjëndje në fund të vitit	<u>8,667,599</u>	<u>-</u>

Proftrans Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

<i>Kosto</i>	Makineri dhe pajisje	Të tjera	Totali
Më 1 janar 2020	66,432,334	3,975,560	70,407,894
Shtesa	11,246,368	159,834	11,406,202
Pakësime	(1,995,000)	(3,037,977)	(5,032,977)
Më 31 dhjetor 2020	75,683,702	1,097,417	76,781,119
Shtesa	13,346,226	-	13,346,226
Pakësime	(11,024,000)	-	(11,024,000)
Më 31 dhjetor 2021	78,005,928	1,097,417	79,103,345
<i>Zhvlerësim i akumuluar</i>			
Më 1 janar 2020	(18,034,244)	(987,384)	(19,021,628)
Shpenzime për vitin	(9,220,820)	(1,366,716)	(10,587,536)
Pakësime	-	1,941,512	1,941,512
Më 31 dhjetor 2020	(27,255,064)	(412,588)	(27,667,652)
Shpenzime për vitin	(10,094,962)	(139,287)	(10,234,249)
Pakësime	5,563,023	-	5,563,023
Më 31 dhjetor 2021	(31,787,003)	(551,875)	(32,338,878)
<i>Vlera e mbartur</i>			
Më 31 dhjetor 2019	48,398,090	2,988,176	51,386,266
Më 31 dhjetor 2020	48,428,638	684,829	49,113,467
Më 31 dhjetor 2021	46,218,925	545,542	46,764,467

9. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogari të pagueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të pagueshme ndaj furnitorëve	9,340,495	6,165,265
Totali	9,340,495	6,165,265

10. TË PAGUESHME NDAJ PUNONJËSVE DHE SIGURIMEVE

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Pagat e punonjësve	1,656,355	-
Kontributet shoqërore dhe shëndetësore	295,226	201,056
Totali	1,951,581	201,056

Më 31 dhjetor 2021 shoqëria kishte 16 të punësuar. Numri mesatar i punëmarrësve gjatë vitit 2021 ishte 12.

Profitrans Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

11. DETYRIME TATIMORE

Detyrime tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Tatimi mbi fitimin	12,419,601	6,250,135
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	447,020	96,171
Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)	77,742	7,023,856
Tatimi i mbajtur në burim	47,647	47,647
Totali	<u>12,992,010</u>	<u>13,417,809</u>

12. TË PAGUESHME TË TJERA AFATSHKURTRA

Të pagueshme të tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Dividend për tu paguar	2,460,000	11,990,247
Totali	<u>2,460,000</u>	<u>11,990,247</u>

13. KAPITALI I NËNSHKRUAR

Më 31 dhjetor 2021 aksionar i Shoqërisë është ADR TRADING sh.p.k. Kapitali i Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 është 100,00 lekë (2020: 13,630,000 lekë).

14. REZERVA

Rezervat ligjore dhe të tjera të krijuara nga Shoqëria deri më 31 dhjetor 2021 kanë një vlerë prej 621,891 lekë (2019: 619,852 lekë).

15. TË ARDHURAT

Të ardhurat më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Transporte	306,978,527	199,848,591
Qira	25,754,254	9,218,977
Shitja mallra	9,700,670	12,861,777
Totali	<u>342,433,451</u>	<u>221,929,345</u>

16. SHPENZIME PËR LËNDËT E PARA

Shpenzime për lëndën e parë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Karburant	50,157,177	34,908,880
Blerje mallrash e shërbimesh	9,221,390	12,734,432
Transporte për blerjet	-	334,125
Ndryshimi i gjendjes së mallrave	(8,667,598)	-

Proftrans Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Totali	50,710,969	47,977,437
---------------	-------------------	-------------------

17. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime për personelin më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Pagat e punonjësve	10,907,709	8,271,503
Kontributet shoqërore dhe shëndetësore	2,236,875	1,180,818
Totali	13,144,584	9,452,321

18. SHPENZIME TË TJERA SHFRYTËZIMI

Shpenzime të tjera shfrytëzimi më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Transporte për shitje	40,280,890	24,566,736
Udhëtime e dieta	8,100,172	5,286,471
Mirëmbajtje dhe riparime mjete	6,276,339	6,580,950
Vlera kontabël e aseteve të shitura	5,460,977	3,091,465
Shërbime profesionale nga të tretë	5,190,800	5,034,127
Shpenzime të tjera të përgjithshme	4,000,427	2,286,840
Qira	3,811,764	3,240,000
Siguracione	2,484,881	2,160,282
Shpenzime per pritje	636,596	729,240
Taksa dhe tarifa të ndryshme	532,438	457,918
Telekomunikacioni	182,949	47,915
Shërbime bankare	154,919	126,832
Gjoha dhe demshperblime	26,508	245,260
Shpenzime 15% tatim ne burim	-	571,764
Blerje kancelari	-	97,395
Totali	77,139,660	54,523,194

19. SHPENZIME FINANCIARE NETO

Shpenzime financiare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
(Fitime) nga kurset e këmbimit	(1,880,087)	(666,247)
Humbje nga kurset e këmbimit	3,444,842	9,423
Shpenzime financiare neto	1,564,755	(656,824)

Proftrans Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

20. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri është vlerësuar në normën 15% (2020:15%) të të ardhurave të tatueshme.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	189,639,234	100,045,680
Shpenzime të pazbritshme	26,508	245,260
Fitimi tatimor për vitin	189,665,742	100,290,940
Tatimi mbi fitimin 15%	(28,449,861)	(15,043,641)
Fitimi neto i vitit	161,189,373	85,002,039

Shpenzimet e pazbritshme lidhen me shpenzime që sipas Ligjit Shqiptar nuk mund t'i zbriten llogaritjes së fitimit/humbjes së tatueshme.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjoha	26,508	245,260
Totali	26,508	245,260

Më poshtë paraqitet rakordimi i normës efektive të tatimit:

	31 dhjetor 2021	Norma efektive e tatimit	31 dhjetor 2020	Norma efektive e tatimit
Fitimi i tatueshë për vitin	189,639,234		100,045,680	
Tatimi mbi fitimin	28,445,885	15.000%	15,006,852	15.000%
Tatimi për shpenzimet e pazbritshme	3,976	0.002%	36,789	0.037%
Totali tatimit mbi fitimin	28,449,861	15.002%	15,043,641	15.037%

21. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie si palë e lidhur me shoqërinë mëmë dhe shoqëri brenda grupit. Një përmbledhje e balancave me palët e lidhura paraqitet më poshtë:

<i>Të arkëtueshme nga palët e lidhura:</i>	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
ADR TRADING	144,000	-

<i>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura:</i>	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
ADR TRADING	11,207,000	137,000

<i>Blerje</i>	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
ADR TRADING	-	-

<i>Shitjet</i>	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
ADR TRADING	12,478,406	-

Profitrans Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

22. ANGAZHIME DHE KUSHTËZIME

Angazhime

Shoqëria nuk ka angazhime materiale të nënkontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat të mos jenë reflektuar në pasqyrat financiare.

Detyrime tatimore

Librat dhe të dhënat kontabël për vitet financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 nuk janë audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore të Shoqërisë mund të mos konsiderohen të finalizuara.

Çështje Gjyqësore

Në rrjedhjen normale të biznesit, Shoqëria ndeshet me pretendime ligjore dhe gjyqësore; menaxhimi i Shoqërisë është i mendimit se asnjë humbje materiale nuk do të shkaktohet në lidhje me kërkesat ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2021.

23. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Pas datës së pasqyrave financiare nuk ka pasur ngjarje për të cilat të nevojiten rregullime në pasqyrat financiare të Shoqërisë.